

RAPORT I I AUDITIT TE PAVARUR

Per krijimin e te ardhurave dhe shpenzimet e kryera nga Partia Bashkimi Republikan i Shqiperise per fushaten e zgjedhjeve te dates 8 MAJ 2011

Drejtuar Komisionit Qendror te Zgjedhjeve
Tirane

Zoterinje te nderuar !

Ne ekzekutim te misionit qe me eshte besuar prej jush , kam nderin t'ju paraqes raportin mbi pasqyrimin e te ardhurave dhe shpenzimeve te Partise Bashkimi Republikan i Shqiperise , ne fushaten e zgjedhjeve te dates 8 Majit 2011 , sipas analizes bashkelidhur.

PERGJEGJESIT RESPEKTIVE

Pergjegjesia per pergatitjen e deklarimit pasqyres financiare eshte e drejtimit te Partise , te cilet mbajne pergjegjesite e plota per saktesine e tyre. Kjo pergjegjesi perfshin: hartimin, zbatimin dhe mbajtjen e kontrollit te brendeshem te pershtatshem mbi pergatitjen dhe paraqitjen e sinqerte te pasqyrave financiare pa anomali, zgjedhjen dhe zbatimin e metodave te pershtatshme kontabel. Gjithashtu eshte pergjegjesia e tyre, per paraqitjen e kesaj pasqyre pa aktivitet.

PERGJEGJESIA E AUDITUESIT

Eshte pergjegjesia ime si audit i pavarur, te shpreh nje opinion te arsyeshem mbi keto pasqyra , duke u mbeshtetur ne Standartet Nderkombetare te Auditimit , ne normat dhe kerkesat e profesionit , kerkesat e vecanta qe ka Kodi Zgjedhor i Shqiperise , per te marre nje siguri te arsyeshme , nese pasqyrat nuk kane anomali materiale , si dhe ne zbatimin e SKK dhe ta raportoj ate para jush.

Auditimi ka perfshire kryerjen e procedurave per te marre evidence auditimi rreth shumave dhe informacioneve te dhena ne pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga audituesi , perfshire ketu edhe vlersimin mbi gjykimet dhe metodat e perdorura nga ana e Partise ne pergatitjen e ketyre pasqyrave, ne perputhje me vecorite specifike te saj.

Opinionimi im eshte mbeshtetur mbi informacionet dhe shpjegimet e vena ne dispozicion pa asnje rezerve nga ana e Partise, ne testimet e kryera , te konsideruara te mjaftushme per mbeshtetjen e opinionit mbi keto pasqyra , te cilat i sherbejne nje qellimi specifik.

Ne formimin e opinionit te auditit u vlersua gjithashtu dhe saktesia e prezantimit te informacionit.

Opinionimi im u mbeshtet edhe ne faktin se drejtimi i Partise kishte njohuri te plote per ligjin, per evidentimin e kontributeve, detyrimet ligjore, pasojat qe sjell moszbatimi korrekt i ligjit dhe pergjegjesite e tyre personale. Te gjitha keto pergjegjesi kryetari i Partise, **z. Zane Llazi**, i deklaroi me shkrim

Ne opinionin tim, gjithashtu jam mbeshtetur edhe ne informacionet e ndryshme qe une kam marre nepermjet shtypit, te shkruar dhe elektronik, informacioneve per koalicionet qe ka bere kjo parti ne fushaten e zgjedhjeve. Kjo Parti ka vepruar ne koalicionin e udhehequr nga Partia Socialiste e Shqiperise. Te gjitha shpenzimet jane perballuar vetem nga Partia Socialiste. Vetem levizja e krereve te Partise neper mitingje eshte bere me automjetet e antarsise.

Une cmoje se auditimi i kryer perben nje baze te arsyeshme per te shprehur opinionin tim te pavarur.

OPINIONI

Bazuar ne auditimin e kryer ,duke u mbeshtetur ne siguri te arsyeshme , sipas opinionit tim si audit, pasqyrat financiare per te ardhurat dhe shpenzimet e Partise Bashkimi Republikan i Shqiperise ,ne fushaten per Zgjedhjet Vendore te Pushtetit Lokal te Shqiperise,te dates 8 Maj te vitit 2011, japin nje pamje reale, te vertete dhe te singerte, ne perputhje me Standartet Kombetare te Kontabilitetit dhe mbeshtetur ne ligjin 10019 date 29.02.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikes se Shqiperise” dhe udhzimet e KQZ.

Tirane me 10.01. 2012

Audit i Pavarur

Qani Kajo

Adresa: Rruga “Myslym Shyri” Pall. 49/1/3
Tel. 04 2244974 Mob.0692070915
Lic. prof. Nr. 76; Nipt K37810309A

PARTISE BASHKIMIT REPUBLIKAN TE SHQIPERISE
Tirane

SHENIME MBI DEKLARIMET FINANCIARE TE FUSHATES ZGJEDHORE
TE VITIT 2011

Fushata per zgjedhjet e Pushtetit Vendor te Shqiperise, ka filluar ligjerisht ne date 08.04.2011 dhe ka mbaruar ne 06 Maj 2011, duke perfunduar me ditën e zgjedhjeve 8 maj 2011. Pasqyrat financiare per periudhen e fushates per kete Parti, nuk nuk jane plotesuar , sepse kjo Parti nuk ka ka pasur te ardhura dhe nuk ka kryer pagesa per fushaten per me fatura shpenzimesh , dokumenta banke etj.

Nga auditimi ketyre dokumentave konstatova:

- 1. Kjo Parti nuk ka perfituar fonde nga buxheti i shtetit per kete fushate zgjedhore.**
- 2. Partia nuk ka perfituar fonde nga donatore te ndryshem, persona fizike, apo juridike vendas.**
- 3. Partia nuk kishte hapur llogari te posacme per fondet e fushates se zgjedhjeve.**

Libri i dhuruesve nuk ishte mbajtur i vecante sipas ligjit pasi nuk kishte fare kontribute te hyra.

Fushata elektorale e Partise ishte mbeshtetur vetem ne koalicionin e saj me Partine Socialiste te Shqiperise, duke mare pjese ne mitingjet e kesaj partie.

Ne kushtet e mesiperme une formova opinionin tim si audit i pavarur se , PBR , nuk ka pasur te ardhura dhe shpenzime per fushaten e zgjedhjeve per Zgjedhjet e Pushtetit Vendore ne vitin 2011, ne baze te Kodit Zgjedhor te Republikës se Shqiperise si dhe vendimeve e udhzymeve te vecanta te KQZ-se.

Tirane me 10.01.2011

Audit i Pavarur

Qani Kajo

